

AKT-THEMELIMI
PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË TREGTARE
"QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC" SH.A

Bashkia Pogradec, njësi e vetëqeverisjes vendore, me seli në Pogradec, përfaqësuar ligjerisht nga **Z. ILIR XHAKOLLI**, në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Pogradec, madhor me zotesi juridike për të vepruar i identifikuar me leternjoftimin me Nr. Personal G20925210Q.

Në mbështetje të, pikës 4 të nenit 25, shkronjës "d" të pikës 1 të nenit 33, shkronjës "d" të nenit 54, shkronjës "f" të nenit 64 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenet 6 -11, nenit 105, nenit 106, nenit 115, nenit 134, nenit 154, nenit 156, të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nenit 32 dhe nenit 36 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për qendren kombetare të regjistrimit", i ndryshuar..

VENDOSI:

Të themelojë shoqërinë "QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC"
Sh.a.

Bazuar në legjislaconin shqipëtar përkatës në fuqi, hartohet akti i themelimit, i cili sanksionon krijimin e shoqërisë dhe përcakton në mënyrë të përgjithshme ndarjen e raportit të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë, organet dhe kompetencat e tyre dhe çështje të tjera si më poshtë vijon:

NENI 1

FORMA JURIDIKE, KOHËZGJATJA DHE SELIA

- 1.1 "QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC" Sh.a, është shoqëri aksionare , me një nivel, me ofertë private.
- 1.2 "QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC" Sh.a, krijohet për një kohëzgjatje të papërcaktuar.
- 1.3 Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve apo në aktet e brendshme do të shënohet emërtimi "QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC" Sh.a.
- 1.4 Selia e shoqërisë "QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC" Sh.a, ndodhet në Pogradec, pranë Qendrës Kulturore "Lasgush Poradeci", Pogradec, kodi postar 7301.

NENI 2

QËLLIMI I SHOQËRISË

- 2.1 "QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC" Sh.a është një shoqëri tregtare, me qëllim fitimi, e cila synon të zhvillojë aktivitetet në Republikën e Shqipërisë ose jashtë Kufijve të Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

OBJEKTI

- 3.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

NENI 7
KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

- 7.1 Këshilli i Administrimit përbëhet nga tre persona fizikë si anëtarë të tij. Emërtimet do të jenë individuale. Anëtarët e Këshillit të Administrimit emërohen dhe shkarkohen nga detyra nga Kryetari i Bashkisë.
- 7.2 Shpërblimi mujor për Këshillin e Administrimit të jetë sipas akteve ligjore në fuqi.
- 7.3 Mandati i Anëtarëve të Këshillit të Administrimit është 3 (tre) vjeçar.
- 7.4 Anëtarët e Këshillit të Administrimit janë të pavarur dhe nuk do të jenë Administratorë.

NENI 8
ADMINISTRATORI

- 8.1 Administratori emërtohet në detyrë nga Këshilli i Administrimit, për një periudhë 3 (Tre) vjeçar. Emërtimi do të jetë individual. Administratori mund të shkarkohen në çdo kohë nga detyra, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë.
- 8.2 Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen dhe shoqëria do të përfaqësohet nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e tyre në përputhje me parashikimet e statutit.

NENI 9
MBULIMI I HUMBJEVE

- 9.1 Humbjet e mundshme të krijuara nga aktiviteti tregtar i shoqërisë përgjatë një viti ushtrimor ose të mbartura, do të mbulohet nga aksionari i vetem.
- 9.2 Mbulimi i humbjeve nga ana e aksionarit mund të kryhet përmes zmadhimit ose zvogëlimit të kapitalit themeltar, emetimit të obligacioneve ose titujve të ndryshëm, ose në çdo formë tjetër të njohur me ligj.

NENI 10
TE TJERA

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë aksionare do të bëhet në përputhje me dispozitat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga Statuti i "QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC" Sh.a.

Ky akt-themelimi hartohet në pesë kopje të njëjta, nga tre flete, në gjuhën shqipe.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

(Përfaqësuar nga ortaku i vetëm, me 100 % të aksioneve, BASHKIA POGRADEC)

(Ligjërishit e përfaqësuar nga Kryetari)

KRYETARI I BASHKISË

ILIR XHAKOLLI

